



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0942

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Horn & Co. Kosova SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të K.K. SKENDERAJ në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender me numër të prokurimit 643-23-10063-2-1-1, me 09.12.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Horn & Co. Kosova SH.P.K. me nr. 2024/0942 , e datës 04/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit 058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender me numër të prokurimit 643-23-10063-2-1-1 inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)- K.K. SKENDERAJ

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit.

3. Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP

5. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 20.09.2023 K.K. SKENDERAJ., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender me numër të prokurimit 643-23-10063-2-1-1.

Me 25.09.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës shërbim me vlerë të kontratës 155,000.00 euro.

Me 26.09.2024 OE Horn & Co. Kosova SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 30.09.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Horn & Co. Kosova SH.P.K., me numër protokollit 2024/0942 lidhur me aktivitetin e prokurimit Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender me numër të prokurimit 643-23-10063-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Horn & Co. Kosova SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: "Edhe pse kemi pranuar vendimin tuaj me datë 09.07.2024 dhe kemi marrë vendimin 2024/0294 nga OSHP-ja për herë të dytë, si dhe vendimin e panelit shqyrtues, të cilin edhe Autoriteti Kontraktues (AK) e ka pranuar, ankesa jonë është aprovuar dhe lënda është kërkuar të kthehet në ri-vlerësim. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së për herë të dytë, dhe me datë 25.09.2024 ka anuluar aktivitetin e prokurimit, duke theksuar në njoftim se "të gjitha ofertat e Operatorëve Ekonomikë (OE) janë të papërgjegjshme". Ky konstatim për anulimin nuk qëndron, pasi vendimi juaj thekson qartë se ka oferta të përgjegjshme në këtë aktivitet prokurimi. Arsyetimi për anulimin, i dhënë nga Autoriteti Kontraktues, nuk është profesional dhe nuk bazohet në asnjë dispozitë ligjore, por duket të jetë subjektiv, duke shkelur Nenin 1, Nenin 6, Nenin 7 dhe Nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP nr. 04/L-042). Ky vendim është i pabazuar, duke pasur parasysh dy vendimet e OSHP-së dhe të Autoritetit Kontraktues, të cilat na kanë vlerësuar si Operator të Përgjegjshëm. Në datën 26.09.2024, kemi dorëzuar një kërkesë për qasje dhe gjithashtu një kërkesë për rishqyrtim. Megjithatë, me datë 30.09.2024, kërkesa jonë për rishqyrtim është hedhur poshtë si e pabazuar dhe është lënë në fuqi vendimi i datës 25.09.2024. Pas verifikimeve të kryera, konstatojmë se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së nr.04/L-042, duke përfshirë nenet e mëposhtme: -Neni 1

par.1 dhe 3: Qëllimi i ligjit;- Neni 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti;- Neni 7 par. 1 dhe 4: Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi.- Neni 59 par.2 dhe 4: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik "Horn & Co. Kosova SH.P.K." me datë 03.11.2023, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt - Ritender" me Nr. të Prok: 643-23-10063-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, gjatë shqyrtimit, analizimit dhe shoshitjes së argumenteve rreth pretendimeve ankimore, sqaron se:Të gjitha pretendimet tuaja lidhur me shkeljet ligjore të nenëve të mëposhtëm janë të paqëndrueshme: Nenet e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092:- Neni 1: Qëllimi i LPP- Neni 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti- Neni 7, par. 1 dhe 4: Barazia në Trajtim dhe Jo-Diskriminimi- Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 07.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0942, ndërsa me datë 17.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik me nr. 2024/0942, me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore janë prezantuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka depozituar ankesë në OSHP, me pretendimin se AK-ja nuk po i respekton vendimet e panelit shqyrtues, me nr. 892/23 dhe 294/24 të OSHP-së. Autoriteti kontraktues, pas pranimit të vendimit të fundit të PSH-së, me nr. 294/24, e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull: Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt, dhe pas përfundimit të rivlerësimit të ofertave e ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme, duke eliminuar të rekomanduarin për kontratë me arsyetimin se ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta, pra, konform vendimit të PSH-së, ndërsa OE ankues e eliminon me arsyetimin se ka ofruar çmime të larta.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues, sqaron se edhe në raportin e vlerësimit të ofertave është konstatuar nga komisioni se çmimet e dhëna nga OE ankues janë çmime të larta. Njëkohësisht, lidhur me këtë çështje, eksperti shqyrtues sqaron se në platformën e E-prokurimit nuk ka vërejtur ndonjë dëshmi se AK-ja ka zhvilluar procedurat e nenit 61 të LPP-së, lidhur me çmimet e ofruara nga OE ankues.

Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues ka parashtruar ankesë dy herë, me nr. 892/23 dhe 294/24, ku eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigjet e tij në të dyja rastet dhe për këto dy ankesa ka marrë edhe dy vendime të PSH-së. Prandaj, ai e konsideron si çështje të gjykuar sipas rregullores së punës së OSHP-së. Ndërsa lidhur me vendimin e fundit të PSH-së, sqaron se është zbatuar pjesërisht, pasi në atë vendim thuhet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe AK-ja e ka kualifikuar si të papërgjegjshëm.

-Gjetjet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues duke analizuar në tërësi provat e dorëzuara në veqanti në përgjigje të pretendimit ankimor të parashtruar nga OE ankues me të cilin OE ankues pretendon se AK me datë 30.09.2024 duke e hedhur poshtë si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe duke lënë në fuqi vendimi i datës 25.09.2024., pretendon se me këtë përgjigje janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së nr.04/L-042, duke përfshirë nenet e mëposhtme: -Neni 1 par.1 dhe 3: Qëllimi i ligjit;- Neni 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti;- Neni 7 par. 1 dhe 4: Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi.- Neni 59 par.2 dhe 4: Ekzaminimi, Paneli Shqyrtues konstaton se AK në përgjigjen e dhënë në letrën standarde për OE të eliminuar me arsyetimin se OE ankues ka ofruar çmime më të larta, vlerëson se AK ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore nga LPP, në veçanti dispozitat ligjore nga neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar, me këtë rast kjo ofertë e ofruar këtë OE e bënë të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Vlenë të theksohet se është në diskrecionin e AK lidhur me trajtimin e OE të cilën ofrojnë çmime më të larta, për më tepër Paneli Shqyrtues konstaton se as OE ankues në ankesën e tij nuk ka paraqitur fakte dhe dëshmi që tregojnë të kundërtën. Andaj, mbi bazën e sqarimeve të përshkruara si më lartë, Paneli konsideron se ka vendosur në mënyrën e duhur dhe të drejtë, kurse AK nëse ka interes të ritenderoj përsëri duke evituar gjatë procedurave të gjitha të metat eventuale si dhe duke zbatuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së në raport më çdo ofertues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se aprovet pjesërisht ankesa e OE ankues lidhur me aktivitetin e prokurimit ndërsa mbetet në fuqi vendimi sa i përket anulimit lidhur me aktivitetin e prokurimit Rrënimin e objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender me numër të prokurimit 643-23-10063-2-1-1., inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal – Skenderaj.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatën Komerciale/Departamenti për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - K.K. SKENDERAJ**
- **OE - Horn & Co. Kosova SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: